



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KRYETARI

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më ____/____/____

Lënda: **Paraqitja e kandidaturës së Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë për t’u bërë anëtare e Byrosë së Shoqatës së Gjykatave Kushtetuese Frankofone (Association des Cours Constitutionnelles Francophones – ACCF)**

Drejtuar: **Zonjës Caroline PÉTILLON**
Sekretare e Përgjithshme e Shoqatës së Gjykatave Kushtetuese Frankofone

E nderuar zonja Sekretare e Përgjithshme,

Nëpërmjet kësaj letre, dëshirojmë të shprehim interesin e Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë për vendosjen e kandidaturës së saj për të qenë anëtare e Byrosë së Shoqatës së Gjykatave Kushtetuese Frankofone, në përputhje me nenin 8/1 të Statutit dhe nenin 11 të Rregullores të kësaj Shoqate.

Që prej krijimit të saj në vitin 1992, Gjykata Kushtetuese e Shqipërisë ka pasur si mision të saj mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, si dhe të vlerave dhe parimeve të demokracisë dhe shtetit të së drejtës, vlera dhe parime të cilat ndan dhe mbi të cilat mbështetet edhe Shoqata e Gjykatave Kushtetuese Frankofone.

Gjykata Kushtetuese e Shqipërisë është anëtare me të drejta të plota e ACCF-së që prej vitit 2002 dhe kontribuese e rregullt e kuotizacionit vjetor të aderimit në Shoqatë. Gjykata ka qenë pjesëmarrëse aktive në pothuaj të gjitha veprimtaritë e organizuara nga ACCF, me synimin e shkëmbimit të përvojave mes gjykatave anëtare, në funksion të zhvillimit të jurisprudencës kushtetuese, përqafimit të praktikave më të mira dhe doktrinae të reja kushtetuese.

Me dëshirën e mirë për t’u angazhuar po kaq aktivisht edhe në mbarrëvajtjen e veprimtarisë organizative të ACCF-së, Gjykata Kushtetuese e Shqipërisë shpreh vullnetin për të qenë edhe pjesë e strukturës së saj drejtuese për të ofruar kontributin në dispozicion të Shoqatës për periudhën 2025 – 2028.

Duke qenë se Gjykata Kushtetuese e Shqipërisë aktualisht ka kryesinë e Konferencës së Gjykatave Kushtetuese Evropiane për periudhën 2024-2027, lutemi mbani në konsideratë që paraqitja e kandidaturës në Byronë e ACCF-së është si anëtare e thjeshtë dhe pa ndonjë funksion.

Duke shpresuar që kandidatura e Gjykatës sonë do të marrë numrin e nevojshëm të votave në Asamblenë e Përgjithshme, në datën 7 maj 2025, ju lutem pranoni, e nderuar zonja Sekretare e Përgjithshme, shprehjen e respektit dhe të konsideratës sonë të lartë.

Holta ZAÇAJ

Kryetare e Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë